

Master Profesional në “Menaxhim i Turizmit Rural” (120 ECTC, 2 vite akademike, me kohë të plotë)

Profili profesional (PËRSHKRIMI I DEGËS)

Ky program studimi vjen pas 3 vjet studimesh të nivelit bachelor. Ai synon të pajisë studentët me njohuritë të thelluara teorike dhe praktike për të qenë të aftë në menaxhimin e biznesit të turizmit rural dhe në zhvillimin e tij nëpërmjet politikave zhvillimore të territorit. Përgatitja e specialistëve të Menaxhimit të Turizmit Rural është parë si një instrument i zhvillimit ekonomik territorial dhe social i zonave rurale.

Modulet kryesore të trajtuara përgjatë studimeve të këtij programi:

a. Formim i përgjithshëm

1. Planifikim Hapsinor
2. Komuniteti Rural dhe Turizmi

b. Formim bazë karakterizues

1. Produktet e Territorit
2. Ekoturizëm
3. Menaxhim i Akomodimit në Turizëm
4. Sjellja e Konsumatorit Turistik II
5. Drejtimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm në Turizëm
6. Marketingu i Turizmit II

c. Formim integrues.

1. Sistemet e Informacionit në Drejtim
2. Drejtim cilësie
3. Politika ushqimore
4. Ekonomi dhe politikat e ambjentit
5. Politikat Publike dhe Zhvillimi Rajonal
6. Menaxhim Projektsh

Mundësitë për punësim

Sektorët kryesorë të punësimit të diplomuarve në Masterin Profesional „Menaxhim i Turizmit Rural“ përfshijnë:

- Sektori privat, që ofron mundësi të mira karriere në pozicione të larta si menaxher dhe administrator të bizneseve të turizmit rural në përgjithësi dhe atij agroturistik në veçanti, si konsulent i biznesit turistik, si dhe pozicione menaxheriale në ndërmjetësit në tregun turistik si Tour Operatorët dhe Agjencitë e udhetimeve. Gjithashtu të diplomuarit në “Menaxhim i Turizmit Rural” mund të punësohen në turizmin masiv dhe në çdo biznes tjetër në pozicion menaxherial dhe të fushës së ekonomisë;
- OJF shqiptare dhe të huaja, si ekspertë, projektues dhe drejtues projektsh zhvillimore

– Sektori publik, përfshirë këtu nivelin e qeverisjes/politikbërjes nga bashkitë deri në nivel qarku, rajoni dhe dikasteri për zhvillimin e turizmit në përgjithësi dhe atij rural në veçanti

PROGRAMI MËSIMOR

Viti, Sem	Nr	Modulet	Kredite	
Viti I, Semestri I (1)	1	Planifikim Hapësinor	5	
	2	Produktet e Territorit	5	
	3	Menaxhimi i Akomodimit në Turizëm	5	
	4	Politikat Publike & Zhvillimi Rajonal	5	
	5	Komuniteti Rural dhe Turizmi	5	
	Module me Zgjedhje 1			
	6	<i>Drejtimit i Qëndrueshëm i Fermave</i> <i>Drejtimit Cilësor</i>	5	
Viti I, Semestri II (2)	1	Biznes Ndërkombëtar	5	
	2	Drejtimi i Rrishtit të Biznesit	5	
	3	Sjellja e Konsumatorit Turistik II	5	
	4	Menaxhim Projektsh	5	
	5	Drejtimi Strategjik i AGB	5	
	Module me Zgjedhje 2			
	6	<i>Politikat Ushqimore</i> <i>Politikat Tregtisë Ndërkombëtare Bujqësore</i>	5	
Viti II, Semestri I (3)	1	Ekoturizëm	5	
	2	Drejtimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm në Turizëm	5	
	3	Marketingu i Turizmi II	5	
	4	Sistemet e Informacionit të Drejtimit	5	
	5	Financa Rurale	5	
	Module me Zgjedhje 3			
	6	<i>Ekonomia dhe Politika të Ambjentit</i> <i>Tregti Ndërkombëtar</i>	5	
Viti II, Semestri II (4)	1	Praktikë Profesionale	20	
	2	Provimi Final	10	
Totali i krediteve	1+2+3+4		120	